

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 12 tetor 2011

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 12 tetor 2011

PROKURORI

k.

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E PËRBASHKËT TË MBROJTJES PËR MASË
ZHDËMTUESE KUNDËR SHKELJEVE TË RREGULLËS 68 NGA
PROKURORIA DHE PËR SANKSIONE SIPAS RREGULLËS 68BIS**

Zyrës së Prokurorit:
Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Mocion i Përbashkët të Mbrojtjes për Masë Zhdëmtuese Kundër Shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për Sanksione sipas Rregullës 68bis”, dorëzuar publikisht me një Shtojcë konfidenciale më 12 shtator 2011 (“Mocion”).

I. HISTORIA PROCEDURALE DHE PARASHTRIMET

1. Ky Mocion ka të bëjë me pretendimin mbi mosnxjerrje materiali prej Prokurorisë lidhur me Dëshmitarin 75, dëshmitar i Prokurorisë nga Kosova, i cili aktualisht banon në një vend të pidentifikuar ku po bën kërkesë për azil (“Vendi i Pidentifikuar”). Përmbledhja e mëposhtme bazohet në parashtrimet dhe dokumentet përcjellëse të palëve.

2. Më 3 nëntor 2010, avokati për azil i Dëshmitarit 75, i shkroi një hetuesi të Zyrës së Prokurorisë (“Prokuroria”) në lidhje me kërkesën për azil të Dëshmitarit 75. Ai e informoi hetuesin e lartpërmendur se kohët e fundit ishte refuzuar kërkesa e Dëshmitarit 75 për azil politik, pjesërisht për arsyen sepse institucioni përkatës në vendin e lartpërmendur kishte konkluduar se rrethanat në Kosovë kishin ndryshuar kështu që Dëshmitari 75 nuk do të vuante më përndjekje politike, siç kishte ndodhur në të shkuarën, në rast se e kthenin në Kosovë dhe se vendimi i atij institucioni në atë kohë ishte në pritje të vendimit të apelit.¹

3. Avokati për azil i kërkoi Prokurorisë një letër ku të përmendej “bashkëpunimi” me Prokurorinë dhe të shprehej “mendimi i Prokurorisë nëse [Dëshmitari 75] ka arsye t’i frikësohet përndjekjes politike në rast se e kthejnë në Kosovë”.²

4. Më 18 nëntor 2010, z. Paul Rogers, Përfaqësues i Lartë i Prokurorisë në këtë çështje shkroi një letër për avokatin e azilit në përgjigje të kërkesës së tij të 5 nëntorit 2010 (“Letra”). Z. Rogers konfirmoi se Dëshmitari 75 kishte dhënë “një deklaratë dëshmitari vullnetare” për Prokurorinë më 16 tetor 2010 në lidhje me rigjykimin *Haradinaj dhe të tjerë*. Ai deklaroi se Dëshmitari 75 “kishte qenë tërësisht bashkëpunues gjatë gjithë kohës, dhe na ka dhënë

¹ Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar hetuesit të Prokurorisë, 5 nëntor 2010, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Pjesa 1.

² Po aty.

informacion të dobishëm dhe të rëndësishëm”, para se të përshkruante shkurtimisht dëshminë e pretenduar inkriminuese që kishte dhënë Dëshmitari 75.³

5. Në Letrën e z. Rogers më tej thuhej: “Nuk mund të komentoj nëse [Dëshmitari 75] ka arsye t’i trembet përndjekjes politike në rast se e kthejnë në Kosovë, mirëpo unë mund të informoj për disa fakte objektive dhe të gjykuara në lidhje me frikësimin e dëshmitarëve në këtë çështje dhe frikësimin e dëshmitarëve në përgjithësi në Kosovë”. Z. Rogers theksoi se problemi serioz i frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë u konfirmua në Aktgjykimin e procesit të parë dhe në Aktgjykimin e Apelit në këtë çështje, pjesë të së cilave u cituan nga z. Rogers. Së fundi, z. Rogers shprehu mendimin e tij dhe të Prokurorisë lidhur me sigurinë e Dëshmitarit 75: “ne gjykojmë se [Dëshmitari 75] dhe familjarët e tij përballen me rrezikun e kërcënimeve të tilla sapo të dihet se ai është dëshmitar i mundshëm në këtë çështje. Gjykojmë [se] ky rrezik është më i madh nëse Dëshmitari 75 do të banonte në Kosovë”.⁴

6. Më 27 janar 2011, z. Richard Harvey, avokati i z. Brahimaj i kërkoi me shkrim z. Rogers nxjerrjen e materialit lidhur me “ndonjë apo të gjitha premtimet apo joshjet e bëra apo të ofruara ndonjë dëshmitari të tillë [që Prokuroria kishte ndërmend të thërriste në rigjykim], ndër të tjera [...] rivendosjen në një vend tjetër të dëshmitarit, familjarëve, miqve ose bashkëpunëtorëve të tij”.⁵

7. Më 2 shkurt 2011, Dëshmitari 75 i dërgoi një mesazh elektronik një hetuesi të Prokurorisë (“Mesazh elektronik”). Dëshmitari 75 pranoi se ai e kishte gënjyer më parë avokatin e tij për azil dhe ishte i shqetësuar mbi rezultatin e kërkesës së tij për azil:

Unë i thashë avokatit tim se vëllai më ishte vrarë në luftë, nuk është e vërtetë, ju e dini të vërtetën, mirëpo unë veprova kështu për hir të familjes sime në Kosovë dhe vetes dhe gruas sime në [Vendin e Pidentifikuar]. [...] Avokati më thotë, pse nuk më tregove të vërtetën, arsyeja është se kam sërish frikë për sigurinë e familjes sime atje dhe këtu, veçanërisht për vetveten [...] Çështja ime këtu është në udhëkryq. Kam nevojë për ndihmën tuaj për sigurinë e jetës sime dhe të familjes sime.⁶

8. Po atë ditë hetuesi u përgjigj: “I kuptoj shqetësimet tuaja dhe do të informoj Prokurorin në lidhje me to”.⁷

³ Letra, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 2.

⁴ Po aty.

⁵ Kërkesë nga Richard Harvey për Nxjerrje Materiali, 27 janar 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 3.

⁶ Mesazh elektronik, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 4.

⁷ Po aty

9. Më 7 shkurt 2011, z. Rogers iu përgjigj kërkesës së z. Harvey për nxjerrjen e materialit të 27 janarit 2011. Z. Rogers u shpreh “nuk mendojmë se ekziston një informacion i tillë” dhe siguroi se ai do ta bënte të njohur një material të tillë në qoftë se do të dilte në dritë.⁸ Më 22 shkurt 2011 dhe sërish më 23 mars 2011, z. Rogers pak a shumë shprehu të njëjtën gjë në një mesazh tjetër për Mbrojtjen.⁹

10. Më 18 korrik 2011, Prokuroria i dha Mbrojtjes deklaratën e intervistës së Dëshmitarit 75 dhe pjesë të deklaratave të Dëshmitarit 75 dhënë institucioneve të Vendit të Pidentifikuar.¹⁰

11. Më 26 gusht 2011, një organ apeli i Vendit të Pidentifikuar mori vendim lidhur me kërkesën për azil të Dëshmitarit 75, të refuzuar më parë. Organi i apelit theksoi veçanërisht se procedura e apelit duhej rihapur për arsye se Dëshmitari 75 kishte paraqitur prova të reja të rëndësishme. Letra e z. Rogers ishte prova e parë që përmendej. Organi i apelit theksonte se Dëshmitari 75 kishte dhënë vullnetarisht Prokurorisë një deklaratë mbi faktet, se Prokuroria priste që ai të dëshmonte dhe se ishin evidentuar rreziqet me të cilat përballej dëshmitari në Kosovë. [Organi i apelit] konkludoi se Dëshmitari 75 kishte provuar *prima facie* se në qoftë se e kthenin në Kosovë, atij mund t’i ndodhte diçka e keqe dhe se rrjedhimisht kërkesa e tij për azil i duhej përcjellë një organi në nivel më të ulët për procedim të mëtejshëm.¹¹

12. Më 20 gusht 2011, z. Rogers nisi me pyetjet për Dëshmitarin 75 në këtë çështje.

13. Më 30 gusht 2011, avokati për azil i dërgoi z. Rogers një kopje të vendimit të organit të apelit për rihapjen e çështjes së apelit të Dëshmitarit 75 bazuar pjesërisht në Letrën e dhënë nga ai.¹²

14. Po atë ditë, Z. Harvey dërgoi një kërkesë tjetër për nxjerrje materiali për z. Rogers duke i kërkuar të bënte të ditur statusin e emigrimit të Dëshmitarit 75. Në kërkesë shtrohej

⁸ Mesazh nga z. Rogers për Avokatin e Mbrojtjes, 7 shkurt 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 5.

⁹ Mesazh nga z. Rogers për Avokatin e Mbrojtjes, 22 shkurt 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 6; Shtojca Konfidenciale A e Mocionit, para 14.

¹⁰ Shtojca Konfidenciale A e Mocionit, para 15.

¹¹ Vendim i Gjykatës së Apelit të Vendit të Pidentifikuar, 26 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 8.

¹² Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar z. Rogers, 30 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 22.

pyetja: “a ka marrë ai azil apo statusin e refugjatit, a është refuzuar një status i tillë, apo ende pritet vendim, ose ka ndonjë status tjetër?”; dhe gjithashtu pyetej nëse Prokuroria kishte bërë ndonjë “ndërhyrje” lidhur me statusin e emigrimit të Dëshmitarit 75 apo kishte marrë “masa” për ta ndihmuar “në marrjen e azilit, statusit të refugjatit, vendosjen në një vend tjetër ose çfarëdo mbrojtjeje apo përfitimi të ngjashëm”.¹³

15. Më 31 gusht 2011, pak para rifillimit të dhënies së dëshmisë së Dëshmitarit 75, z. Rogers u përgjigj si më poshtë:

[...] me sa dimë po diskutohet rishikimi i statusit të emigrimit të dëshmitarit nga (Vendi i Pidentifikuar).

[...] Prokuroria është e paqartë se çfarë doni të thoni me “ndërhyrje”. Avokati për azil i dëshmitarit në fakt na kontaktoi pas dhënies së deklaratës nga dëshmitari duke na kërkuar nëse mund t’i jepnim një letër lidhur me bashkëpunimin e dëshmitarit me Prokurorinë dhe nëse do të ishte e mundshme një mendim nëse po të kthehej në Kosovë, dëshmitari kishte arsye të frikësohej prej përndjekjes politike. Bashkëngjitur keni përgjigjen time.¹⁴

16. Në përgjigjen e tij z. Rogers bashkëngjiti Letrën e 18 nëntorit 2010, duke ia paraqitur Mbrojtjes për herë të parë.¹⁵ Mirëpo ai nuk zbuloi njëherazi edhe kërkesën në përgjigje të së cilës ishte shkruar letra, dhe as mendimin e organit të apelit për rihapjen e çështjes së azilit të Dëshmitarit 75, të cilin e kishte marrë nëpërmjet postës elektronike një ditë më parë.¹⁶

17. Në një seancë të mëtejshme gjyqësore më 31 gusht 2011, Mbrojtja pretendoi se z. Rogers kishte shkëlur Rregullën 68 nëpërmjet mosnxjerrjes së letrës deri atëherë dhe nëpërmjet mosnxjerrjes së materialit shtesë lidhur me çështjen e azilit të Dëshmitarit 75. Mbrojtja argumentoi se këto probleme ishin të rëndësishme lidhur me besueshmërinë e Dëshmitarit 75.¹⁷

18. Z. Rogers u përgjigj se Letra e tij u shkrua “pasi dëshmitari kishte dhënë deklaratën e tij dhe jo në shkëmbim të saj” dhe nuk mund “të konkludohet se ajo cenon besueshmërinë e dëshmitarit”.¹⁸ Ai deklaroi se nuk ia kishte zbuluar më parë Mbrojtjes sepse ajo nuk ishte

¹³ Mesazh elektronik nga z. Harvey dërguar z. Rogers, 30 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 9.

¹⁴ Mesazh elektronik nga z. Rogers dërguar Avokatit të Mbrojtjes, 31 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 10.

¹⁵ Shtojca Konfidenciale A e Mocionit, para 22.

¹⁶ Shtojca Konfidenciale A e Mocionit, para 22.

¹⁷ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Transkript (“T”) në 879-881, 888-890 dhe më tej.

¹⁸ T. 884.

brenda kuadrit të kërkesës për nxjerrje materiali të 27 janarit 2011 nga Z. Harvey. Pretendohet se Letra nuk përmbante informacion që “objektivisht mund të konsiderohej formë presioni, kërcënimi apo joshjeje lidhur me dëshminë e dëshmitarit, dhe kjo është arsyeja që nuk iu bë e njohur z. Harvey në përgjigje të kërkesës së tij”.¹⁹

19. Z. Rogers theksoi se ai nuk kishte ndërmend të kryente kundërvajtje²⁰ dhe nënvizoi se i ishte përmbajtur Rregullës 68 në të shkuarën duke e informuar Mbrojtjen për “dokumentet e azilit” të Dëshmitarit 75. Sipas tij, “dokumentet e azilit” kishin rëndësi për besueshmërinë e tij duke marrë parasysh mospërputhjet faktuale midis deklaratave të tij dhënë autoriteteve të Vendit të Pidentifikuar dhe deklaratave të tij për Prokurorinë.²¹ Z. Rogers bëri dallim midis “dokumenteve të azilit” të Dëshmitarit 75 dhe Letrës së tij: “[Çfarë shkruhet në dokumentet e azilit] sigurisht që ka rëndësi për besueshmërinë e tij. Nuk gjej arsye që të njëjtat kritere vlejnë për letrën që u shkrua për arsyet që tashmë kam shpjeguar. [...] Nuk gjykoj se ky problem u shfaq brenda kuadrit të Rregullës 68 as në atë kohë, dhe as aktualisht [...]. Ne nuk e konsiderojmë si çështje të Rregullës 68”.²² Ai përcaktoi se letrën e kishte nxjerrë vetëm “në mënyrë që të qartësonim çfarë kishte ndodhur, dhe jo sepse gjykoja se kishte ndonjë rëndësi lidhur me besueshmërinë”.²³

20. Mbrojtja u kundërpërgjigj se informacioni lidhej me motivet e Dëshmitarit 75 për të dëshmuar për Prokurorinë dhe rrjedhimisht ishte brenda kuadrit të Rregullës 68 dhe kërkesave të mëparshme të Mbrojtjes për nxjerrje materiali.²⁴ Ajo theksoi se z. Rogers shkeli Rregullën 68 pavarësisht nëse shkelja ka qenë ose nuk ka qenë e qëllimshme.²⁵ Gjithashtu Mbrojtja theksoi se z. Rogers kishte detyrë t’ia tregonte Mbrojtjes këtë informacion pavarësisht nëse Mbrojtja e kishte kërkuar ose nuk kishte kërkuar informacionin.²⁶

21. Menjëherë pas rifillimit të pyetjeve të Prokurorisë për Dëshmitarin 75, z. Rogers më së fundi i bëri dëshmitarit këtë pyetje; “A keni marrë azil dhe më pas është rishikuar ose ju është hequr?”²⁷ Më vonë atë ditë, z. Harvey paraqiti një kërkesë tjetër me shkrim për nxjerrje

¹⁹ T. 884.

²⁰ T. 886-883, 892-893.

²¹ T. 951.

²² T. 951-952.

²³ T. 954. Shih edhe T. 1001, 1006 (ku gjithashtu kundërshtohet rëndësia e këtij materiali).

²⁴ T. 886-890, 893-894. Shih edhe Mocion, para 20.

²⁵ T. 894.

²⁶ T. 889.

²⁷ T. 916.

materiali nga z. Rogers ku shprehej se “duke u bazuar në pyetjet që i bëtë [Dëshmitarit 75] [...] duket qartë se ju zotëroni informacion tjetër lidhur me kërkesën e dëshmitarit për azil [...]”. Z. Harvey i kërkoi z. Rogers të nxirrte urgjentisht “të gjitha dokumentet dhe informacionin që keni lidhur me kërkesën e [Dëshmitarit 75] për status azilanti/refugjati dhe “ecurinë” ose “rezultatin” e saj si dhe letërkëmbimin midis Prokurorisë dhe avokatit për azil të Dëshmitarit 75 dhe autoriteteve të emigrimit të Vendit të Pidentifikuar. Z. Harvey bëri të ditur se ai kishte ndërmend ta përdorte këtë material në pyetjet që do t’i bënte Dëshmitarit 75.²⁸

22. Më 1 shtator 2011, disa çaste para fillimit të seancës së planifikuar gjyqësore, z. Rogers iu përgjigj kërkesës më të fundit të z. Harvey dhe paraqiti: i) vendimin e organit të apelit të Vendit të Pidentifikuar për rihapjen e çështjes së azilit pjesërisht duke u bazuar në Letrën e z. Rogers; dhe ii) Mesazhin Elektronit të Dëshmitarit 75 të 2 shkurtit 2011, ku ai kërkonte ndihmën e Prokurorisë lidhur me kërkesën e tij për azil dhe pranonte se e kishte gënjyer avokatin e tij për azil.²⁹

23. Në fillim të seancës gjyqësore të asaj dite, Mbrojtja argumentoi se nxjerrja e vonuar e këtyre materialeve përbënte një tjetër shkelje të rëndë të Rregullës 68 dhe kërkoi që z. Rogers t’i jepej vërejtje si masë ndëshkimore bazuar në Rregullën 68bis.³⁰ Z. Rogers pranoi se ai duhej ta kishte nxjerrë Mesazhin Elektronik më herët,³¹ mirëpo këmbënguli se informacioni tjetër lidhur me çështjen e azilit të Dëshmitarit 75 ishte i parëndësishëm.³²

24. Mbrojtja bëri kërkesë gojore që Dhoma të urdhëronte z. Rogers që të nxirrte kërkesën në përgjigje të së cilës ishte dërguar Letra³³ (mesazhi i lartpërmendur i 5 nëntorit 2010 nga avokati për azil drejtuar Prokurorisë).³⁴ Z. Rogers e nxori këtë provë pasi u urdhërua nga Kryegjykatësi:

²⁸ Mesazh elektronik nga z. Harvey dërguar z. Rogers, 31 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 11.

²⁹ Mesazh elektronik nga z. Rogers dërguar Avokatit të Mbrojtjes, 1 shtator 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 12.

³⁰ T. 978-996 dhe më tej.

³¹ T. 1000.

³² T. 1001, 1006.

³³ T. 1005-1010.

³⁴ Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar hetuesit të Prokurorisë, 5 nëntor 2010, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 1.

Z. EMMERSON I kërkuam të na e jepte, ai nuk na e dha. Atëherë ne ju kërkojmë që ta urdhëroni.

GJYKATËSI MOLOTO Z. Rogers, ende refuzoni ta jepni këtë letër?

Z. ROGERS Jo, I Nderuar Gjykatës. Nuk është puna se refuzojmë ta japim.

GJYKATËSI MOLOTO A jeni i gatshëm t'ua jepni tani?

Z. ROGERS Puna është se duhet të përpiqemi ta trajtojmë në të gjitha aspektet. Kjo është arsyeja.

GJYKATËSI MOLOTO Pyetja ime për ju është a jeni i gatshëm t'ua jepni tani? Po apo ajo ?

Z. ROGERS Po

GJYKATËSI MOLOTO Në rregull. Jepuani.³⁵

25. Më pas Dhoma i ftoi palët të dorëzonin parashtrime me shkrim në lidhje me çështjen dhe urdhëroi që dëshmidhënia e Dëshmitarit 75 të shtyhej deri në vendimin mbi parashtrimet e palëve sipas Rregullës 68.³⁶

26. Më 12 shtator 201, Mbrojtja dorëzoi Mocionin ku argumenton se Prokuroria ka kryer një shkelje të rëndë të Rregullës 68 dhe kërkon që bazuar në Rregullën 68bis, z. Rogers t'i jepet vërejtje.³⁷ Mbrojtja argumenton se të Akuzuarit u paragjykuan prej shkeljes sepse Mbrojtja është privuar prej materialit të rëndësishëm për pyetjet e saj ndaj Dëshmitarit 75, duke shkelur kështu të drejtën e të Akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë.³⁸ Mbrojtja kërkon që Dhoma të arrijë përfundime të arsyeshme në dobi të të Akuzuarve lidhur me provat e nxjerra.³⁹

27. Mbrojtja kërkon që Dhoma të urdhërojë Prokurorinë që të nxjerrë çfarëdo materiali të mbetur në lidhje me procedurën e azilit të Dëshmitarit 75, si dhe të zbulojë “të gjitha komunikimet dhe kontaktet midis Prokurorisë dhe Dëshmitarit 75 para dhe pas Mesazhit Elektronit të dëshmitarit të 2 shkurtit 2011, të gjitha komunikimet dhe kontaktet midis Prokurorisë dhe avokatit të Dëshmitarit 75 para dhe pas letrës së z. Rogers të 18 nëntorit 2010 dhe të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin lidhur me procedurën e emigrimit të

³⁵ T. 1009-1010.

³⁶ T. 1016-1017.

³⁷ Mocion, para 27, 30-33.

³⁸ Mocion, para 28.

³⁹ Mocion, para 29.

Dëshmitarit 75”.⁴⁰ Mbrojtja shton se Prokuroria duhet të “përgatisë një raport lidhur me të gjitha masat që ka marrë për rishikimin e dosjeve të veta për Dëshmitarin 75 dhe të bëjë të njohur çfarëdo problemi lidhur me nxjerrje materiale që ka hasur dhe për masat që mund të merren për zgjidhjen e këtyre problemeve”.⁴¹ Po ashtu Mbrojtja kërkon zbatimin e një procedure të re nëpërmjet së cilës Prokuroria do të paraqiste një “raport për nxjerrje materiali” së paku shtatë ditë para dhënies së dëshmisë së secilit prej dëshmitarëve të tjerë të saj.⁴²

28. Më 20 shtator 2011, Prokuroria iu përgjigj Mocionit, duke shprehur kundërshtim ndaj sanksioneve të Rregullës 68bis dhe çfarëdo mase zhdëmtuese, veç shtyrjes së dhënies së dëshmisë së Dëshmitarit 75 që ishte urdhëruar më parë prej Dhomës.⁴³ Prokuroria argumenton se shkelja e vetme e Rregullës 68 ishte nxjerrja e vonuar e Mesazhit Elektronik të Dëshmitarit 75, thjesht një “pakujdesi”, ndonëse saktëson se data më e hershme që duhej të ishte nxjerrë ishte 18 korrik 2011 sepse Dëshmitari 75 ishte dëshmitar i zbuluar më vonesë.⁴⁴ Prokuroria argumenton se të Akuzuarit nuk kanë pësuar ligjërisht paragjykim si pasojë e nxjerrjes së vonuar të Mesazhit Elektronik, sidomos për shkak të shtyrjes së pyetjeve të Mbrojtjes për Dëshmitarin 75.⁴⁵

29. Ndryshe, Prokuroria rithekson qëndrimin e saj të mëparshëm se Mesazhi Elektronik është i rëndësishëm për Rregullën 68 vetëm sepse pohohet se Dëshmitari 75 kishte gënjyer avokatin e tij për azil; kurse pjesa tjetër e informacionit lidhur me kërkesën e tij për azil, është e parëndësishme.⁴⁶ Gjithashtu Prokuroria shton se nuk ka asgjë “që sugjeron motiv të Dëshmitarit 75 për të dëshmuar në dobi të Prokurorisë” në shkëmbim të ndihmës së saj për kërkesën e azilit të tij.⁴⁷ Prokuroria nënvizon se “nuk shprehu përkrahje për ndonjë rezultat në procedurën e azilit të Dëshmitarit 75”.⁴⁸

⁴⁰ Mocion, para 34.

⁴¹ Mocion, para 35.

⁴² Mocion, para 37-38.

⁴³ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Masë Zhdëmtuese Kundër Shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për Sanksione sipas Rregullës 68bis dorëzuar publikisht me një Shtojcë konfidenciale më 20 shtator 2011 (“Përgjigje”).

⁴⁴ Përgjigje, para 3, 9-10.

⁴⁵ Përgjigje, para 4, 5, 22-25.

⁴⁶ Përgjigje, para 9-11.

⁴⁷ Përgjigje, para 2-3.

⁴⁸ Përgjigje, para 2. Shih po aty në 14.

30. Përgjigjes së saj Prokuroria i ka bashkëngjitur një Shtojcë konfidenciale të cilën “e ka dorëzuar me status të jashtëzakonshëm [...] për të trajtuar në mënyrën e duhur pretendimet e pabaza të ngritura prej të Akuzuarve në Mocion. Kjo Shtojcë përmban një listë të kontakteve dhe letërkëmbimit të Prokurorisë me Dëshmitarin 75 dhe avokatin e tij për azil,⁴⁹ të përshkruara më poshtë.

31. Gjithashtu Prokuroria pranon se ka pasur “kontakte” me “autoritetet e emigrimit të vendit ku Dëshmitari 75 kërkon azil”.⁵⁰ Bëhet e ditur se “ky ishte i vetmi material në zotërim të Prokurorisë lidhur me statusin e emigrimit të Dëshmitarit 75 të cilin nuk e përfshiu në Shtojcën e Përgjigjes”.⁵¹ Prokuroria deklaron se “mori masa për marrjen e pëlqimit të [Vendit të Pidentifikuar] veçanërisht për paraqitjen e këtyre kontakteve në Përgjigje për të treguar se pretendimet e Mocionit janë të pabaza mirëpo [Vendi i Pidentifikuar] nuk pranoi të jepte pëlqimin”.⁵²

32. Më 23 shtator 2011, Mbrojtja kërkoi leje për paraqitjen e kundërpërgjigjes sepse në Përgjigjen e saj Prokuroria kishte nxjerrë për herë të parë një sasi të madhe materialesh të reja lidhur me Dëshmitarin 75” në Shtojcën e Përgjigjes.⁵³ Mbrojtja thekson veçanërisht se Prokuroria “i zbuloi këto materiale vetëm “si përjashtim” dhe vetëm për të treguar se gjithsesi ato nuk mund të nxirreshin”.⁵⁴ Mbrojtja vërejti se “duket se z. Rogers nuk do të nxjerrë materiale të ngjashme për cilindo prej dëshmitarëve të tjerë”.⁵⁵

33. Mbrojtja shton se Vendi i Pidentifikuar nuk ka dhënë “arsye” për refuzimin për të nxjerrë këtë material dhe se ky qëndrim “përbën refuzim të gjithanshëm për zbulimin e çfarëdo informacioni për Mbrojtjen, që nuk është i palejueshëm sipas Rregullës 70”.⁵⁶ Ajo thekson se Vendi i Pidentifikuar “nuk është mbështetur në Rregullën 70 apo ndonjë

⁴⁹ Përgjigje, para 6.

⁵⁰ Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Masë Zhdëmtuese Kundër Shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për Sanksione sipas Rregullës 68bis, 20 shtator 2011 (“Përgjigje”), para 7.

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty.

⁵³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Masë Zhdëmtuese Kundër Shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për Sanksione sipas Rregullës 68bis, dorëzuar publikisht më 23 shtator 2011 (“Kundërpërgjigje”), para 2.

⁵⁴ Kundërpërgjigje, para. 6.

⁵⁵ Kundërpërgjigje, para. 16.

⁵⁶ Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Masë Zhdëmtuese Kundër Shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për Sanksione sipas Rregullës 68bis, dorëzuar publikisht më 23 shtator 2011 (“Kundërpërgjigje”), para 19.

dispozitë tjetër të Statutit apo Rregullores”.⁵⁷ Sipas Mbrojtjes “asgjë në materialet e paraqitura nga Prokuroria nuk tregon se Prokuroria e ka informuar qeverinë mbi bazën e kësaj kërkesë dhe arsyet konkrete për të”.⁵⁸ Mbrojtja ka kontaktuar drejtpërsëdrejti Vandin e Pidentifikuar duke i kërkuar këto materiale, megjithëse ende nuk kishte marrë përgjigje në kohën kur paraqiti Kundërpërgjigjen.⁵⁹

34. Mbrojtja kërkon që pjesë të seancave të 31 gushtit dhe 1 shtatorit lidhur me problemet e nxjerrjes së materialit përsa i përket Dëshmitarit 75 të bëhen publike me përjashtim të informacionit konfidencial.⁶⁰ Parimisht Prokuroria nuk e kundërshton këtë kërkesë.⁶¹ Mbrojtja sugjeron se palët “kërkojnë të arrijnë marrëveshje lidhur me redaktimet e nevojshme dhe t’i raportojnë Dhomës Gjyqësore në mënyrë që ajo të mund të lëshojë urdhrin e përshtatshëm”.⁶²

35. Së fundi, më 6 tetor 2011, Mbrojtja i paraqiti Dhomës informacion plotësues lidhur me Dëshmitarin 75.⁶³ Informacioni në fjalë ishte: i) kërkesa e drejtpërdrejtë e z. Harvey për avokatin e azilit, dërguar më 20 shtator 2011, për nxjerrjen e dokumentit të apelit të azilit që ai kishte dorëzuar në emër të Dëshmitarit 75; ii) një mesazh elektronik nga avokati për azil drejtuar z. Rogers ku e pyeste nëse mund t’ia tregonte këtë dokument Mbrojtjes; iii) përgjigjja e z. Rogers për avokatin e azilit, gjithashtu dërguar z. Harvey ku z. Rogers pak a shumë thotë se ai nuk do të prononcohej për çështjen (“veproni si ta gjykoni të përshtatshme”); iv) përgjigjja e z. Harvey për avokatin e azilit ku pohohet se dokumenti do të mbahej konfidencial dhe ku pretendohet se më parë avokati i kishte dhënë z. Rogers një kopje të dokumentit të apelit të azilit; v) një mesazh elektronik vijues nga avokati për azil me datë 4 tetor 2011 ku pranon kërkesën e z. Harvey dhe bashkëngjit dokumentin e apelit të azilit; dhe vi) një kopje e dokumentit të apelit të azilit ku përmendet gjerësisht Letra e z. Rogers.⁶⁴

36. Prokuroria dorëzoi një përgjigje ku theksonte se dokumenti i apelit i avokatit të azilit vinte gabimisht në gojën e z. Rogers deklarata të Dhomës Gjyqësore të procesit të parë të

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Kundërpërgjigje, para. 19.

⁶⁰ Mocion, para. 40.

⁶¹ Përgjigje, para. 31.

⁶² Kundërpërgjigje, para. 23.

⁶³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Informacion Plotësues lidhur me Dëshmitarin 75, dorëzuar konfidencialisht më 6 tetor 2011 (“Informacion Plotësues nga Mbrojtja”).

⁶⁴ Po aty në Shtojcat konfidenciale A-D.

cilat z. Rogers i kishte cituar në Letër.⁶⁵ Gjithashtu Prokuroria mohon se avokati i azilit i kishte dërguar më parë z. Rogers një kopje të dokumentit të apelit të azilit, duke bashkëngjitur një mesazh tjetër elektronik të z. Rogers si provë.⁶⁶ Bazuar në argumentet e Prokurorisë Dhoma pranon se Prokuroria nuk ishte në zotërim të dokumentit të apelit të azilit.

II. LIGJI PËRKATËS

37. Në paragrafin i të Rregullës 68 përcaktohet se “sa më shpejt që të ketë mundësi, Prokurori i bën të njohur Mbrojtjes çdo material i cili, me sa është në dijeni Prokurori, mund të çojë drejt sugjerimit të pafajësisë ose lehtësimit të fajësisë së të akuzuarit, ose mund të ndikojë në besueshmërinë e provave të Prokurorit”.

38. Dhoma e Apelit ka përcaktuar se “materiali ndikon në besueshmërinë e provave të Prokurorit në rast se dobëson aktakuzën e paraqitur nga Prokuroria në gjyq”.⁶⁷ Kuadri i Rregullës 68 “përfshin *gjithë atë informacion që në çfarëdo mënyre mund të çojë drejt sugjerimit të pafajësisë ose lehtësimit të fajësisë së të akuzuarit, ose mund të ndikojë në besueshmërinë e provave të Prokurorit, si dhe materialin që e paralajmëron të akuzuarin se një material i tillë ekziston*”.⁶⁸ Me fjalë të tjera “kriteri i vlerësimit nëse materiali është shfajësues brenda kuptimit të Rregullës 68(A) të Rregullores është nëse duke marrë parasysh argumentet e palëve ekziston ndonjë mundësi që informacioni në fjalë të jetë i rëndësishëm për mbrojtjen e të akuzuarit”.⁶⁹

39. “Nxjerrja e materialit shfajësues është themelore për ndershmërinë e procesit të Tribunalit dhe faktori i ndershmërisë së procesit është faktori mbizotërues në konkluzionin nëse ka pasur shkelje të rregullës përkatëse”.⁷⁰ Dhoma e Apelit ka theksuar se “nuk do të tolerojë asgjë që nuk përputhet përpikmërisht me detyrimet për nxjerrjen e materialit”.⁷¹

⁶⁵ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Parashtrim i Prokurorisë mbi Informacionin Plotësues të Brahimajt Lidhur me Dëshmitarin 75, dorëzuar konfidencialisht më 7 tetor 2011, para 3.

⁶⁶ Po aty në para 2.

⁶⁷ *Prokurori k. Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykim, 19 prill 2004 (“Aktgjykimi i Apelit Kërstiq”), para 178.

⁶⁸ Po aty, para 179 (theksi i shtuar).

⁶⁹ *Prokurori k. Llukiqit dhe Llukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-T, Vendim Konfidencial mbi Mocionin e Millan Llukiqit për Masa Zhdëmtuese Për Shkak të Shkeljeve të Detyrimit për Nxjerrje Materiali nga Prokuroria, 12 maj 2001 (“Vendimi Llukiq”), para 14 (theksi i shtuar).

⁷⁰ Aktgjykimi i Apelit Kërstiq, para 180.

⁷¹ Po aty, para 215. Shih edhe Vendimi Llukiq, para 23.

40. Në çështjen *Kërstiq*, Prokuroria deklaroi se një dëshmi apo provë nuk përfshihet brenda kuadrit të Rregullës 68, në qoftë se nuk është shfajësuese “në pamje të parë”.⁷²

Dhoma e Apelit e hodhi poshtë këtë argument:

Dhoma e Apelit është e ndërgjegjshme se një interpretim më i gjerë i detyrimit për nxjerrjen e provave fare mirë mund ta rëndojë barrën e Prokurorisë, si në lidhje me sasinë e materialit që do të nxirret, po ashtu edhe në përpjekjet për të përcaktuar nëse materiali është shfajësues. Mirëpo duke mbajtur parasysh rëndësinë themelore të nxjerrjes së provave shfajësuese, kufizimi i kuadrit të Rregullës 68 në mënyrën e sugjeruar nga Prokuroria bie ndesh me parimin e gjykimit të drejtë.⁷³

41. Një shembull tjetër nga jurisprudenca e Tribunalit është konkluzioni i Dhomës Gjyqësore në çështjen *Furunxhija* se Prokuroria kishte kryer “kundërvajtje të rëndë” duke mos nxjerrë material të Rregullës 68 deri pas argumenteve përmbyllëse, në një kohë që pritej Vendimi i Gjykimit.⁷⁴ Materiali në fjalë ishte një vërtetim thuajse trevjeçar që bënte të ditur se një dëshmitar i Prokurorisë ishte mjekuar nga ana mendore.⁷⁵ Dhoma Gjyqësore konkludoi se kjo provë “sigurisht që kishte të ngjarë të ndikonte në besueshmërinë e provave të prokurorisë” sepse kishte të bënte me kujtesën e dëshmitarit.⁷⁶ Mbrojtja ishte paragjykuar sepse nuk ishte në gjendje të pyeste dëshmitarët e Prokurorisë ose të paraqiste prova lidhur me çështjen.⁷⁷ Për t’ia ofruar këtë mundësi Mbrojtjes, Dhoma Gjyqësore vendosi të rihapte procesin gjyqësor në interes të drejtësisë.⁷⁸

42. Në rast se konkludohet se Prokuroria ka shkelur Rregullën 68, Dhoma duhet të përcaktojë nëse Mbrojtja është paragjykuar nga shkelja para se të gjykojë mbi përshtatshmërinë e një mase zhdëmtuese.⁷⁹

43. Për shembull Dhoma Gjyqësore në çështjen *Oriq* urdhëroi si masë zhdëmtuese për shkelje të Rregullës 68 që Prokuroria të verifikonte gjerësisht për materiale të Rregullës 68 dhe t’i jepte Dhomës Gjyqësore një deklaratë ku të informonte çfarë verifikimesh kishte kryer, ku i kishte kryer dhe rezultatet e këtyre verifikimeve.⁸⁰ Dhoma Paragjyqësore në

⁷² Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para 179.

⁷³ Po aty.

⁷⁴ *Prokurori k. Furunxhisë*, Lënda Nr. IT-95-17/1-T, Vendim, 16 korrik 1998 (“Vendimi *Furunxhija*”), para 16.

⁷⁵ Po aty, para 2.

⁷⁶ Po aty, para 17-18.

⁷⁷ Po aty, para 19.

⁷⁸ Po aty, para 21.

⁷⁹ Vendimi *Llukit*, para 15.

⁸⁰ *Prokurori k. Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-T, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes Lidhur me Mosrespektimin prej Prokurorisë të Rregullës 68, 27 tetor 2005 (“Vendimi *Oriq*”), f 5.

Kërnojelac mori një masë zhdëmtuese të ndryshme kur e urdhëroi Prokurorinë të dorëzonte një raport të nënshkruar nga një anëtar i një prej ekipeve të saj gjyqësore ku ndër të tjera të konfirmohej se ishte kryer një verifikim i plotë “i gjithë materialeve në zotërim të prokurorisë ose ndryshe në dijeni të prokurorisë për ekzistencën e provave të tilla”.⁸¹

44. Rregulla 68*bis* gjithashtu përcakton se “Dhoma Gjyqësore mund të vendosë *proprio motu* ose me kërkesë të cilësdo palë, në lidhje me sanksionet ndaj palës që nuk i përmbush detyrimet për nxjerrje materiali në bazë të Rregullores”.

III. DISKUTIM

A. A e Shkeli Prokuroria Rregullën 68

1. Rëndësia e Çështjes së Azilit të Dëshmitarit 75 për Rregullën 68

45. Fillimisht, Dhoma gjykon se provat lidhur me kërkesën për azil të Dëshmitarit 75 sigurisht që janë të rëndësishme për besueshmërinë e tij. Marrja e azilit është shumë e rëndësishme për Dëshmitarin 75 dhe familjen e tij. Dëshmitari 75 dhe avokati i tij i azilit e kanë informuar vazhdimisht Prokurorinë se përkrahja e saj mund të ndihmonte në miratimin e kërkesës për azil. Faktikisht Letra e z. Rogers ishte faktor në vendimin e organit të apelit të Vendit të Pidentifikuar për rihapjen e çështjes së azilit të tij. Të gjitha këto fakte janë qartazi të rëndësishme për vlerësimin e besueshmërisë së Dëshmitarit 75, gjegjësisht se ai mund të ndihet i detyruar t’a shpërblejë nderin duke dëshmuar në dobi të Prokurorisë.

46. Në kuadër të pretendimit të tij të përsëritur se kjo provë është e parëndësishme lidhur me besueshmërinë e Dëshmitarit 75,⁸² z. Rogers theksoi se Letra e tij “nuk u shkrua në mbështetje të kërkesës për azil të Dëshmitarit 75”.⁸³ Gjithsesi, pavarësisht nga çdo synim subjektiv i mundshëm i z. Rogers në kohën kur shkroi Letrën, thjesht ekzistenca e Letrës ka lidhje me Rregullën 68. Megjithatë Mbrotjtja i zmadhon faktet kur deklaron se z. Rogers kishte dërguar “një letër reference”⁸⁴ – ai nuk argumentonte se Dëshmitari 75 meritonte azil

⁸¹ *Prokurori k. Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Ndryshim të Urdhrit për Respektim të Rregullës 68, para 11.

⁸² T. 884, 951-952, 954, 1001, 1006; Përgjigje, para 11, 21.

⁸³ Përgjigje, para 12-14. Shih edhe T. 884.

⁸⁴ Mocion, para 31.

ose nuk bënte komente në dobi të tij – Letra e tij në fakt ofroi ndihmë të konsiderueshme ndaj kërkesës së Dëshmitarit 75. Provat se Prokuroria ka ofruar ose mund të ofrojë çfarëdo forme objektive ndihme për një dëshmitar është katërcipërisht brenda juridiksionit të Rregullës 68.⁸⁵

47. Dhoma rikujton se Dëshmitari 75 i dha një deklaratë Prokurorisë më 16 tetor 2010; se avokati i tij më pas kërkoi një letër nga z. Rogers lidhur me bashkëpunimin e Dëshmitarit 75 me Prokurorinë ku bëhej e ditur se Dëshmitarit 75 i ishte refuzuar azili dhe se çështja e tij ishte në apel dhe se z. Rogers i dha një Letër në përgjigje të kërkesës së tij. Më 25 nëntor 2010, avokati i Dëshmitarit 75 paraqiti apelimin bazuar ndër të tjera në letrën e z. Rogers, faktor që e bëri organin e apelit që të urdhëronte rihapjen e çështjes së Dëshmitarit 75. Nga rrethanat del qartë se materiali lidhur me implikimin e Prokurorisë në çështjen e azilit të Dëshmitarit 75 “mund të ndikonte në besueshmërinë e provave të Prokurorisë”,⁸⁶ mund të dobësojë aktakuzën e paraqitur nga Prokuroria në gjyq”,⁸⁷ dhe rrjedhimisht duhej të ishte nxjerrë në bazë të Rregullës 68. Z. Rogers e dinte se çështja e azilit të Dëshmitarit 75 ishte në apel dhe se letra e dhënë prej tij do të përdorej në apel. Dhoma konkludon se z. Rogers duhej të ketë qenë i vetëdijshëm se materiali në fjalë kishte lidhje me Rregullën 68.

2. Mosnxjerrja prej Prokurorisë e Materialeve Lidhur me Çështjen e Azilit të Dëshmitarit 75

48. Dhoma gjykon se Prokuroria ka shkelur Rregullën 68 nëpërmjet mosnxjerrjes në kohë të materialit konkret përkatës kërkuar nga Mbrojtja.

49. Prokuroria pranon se mosnxjerrja prej saj e Mesazhit Elektronik të Dëshmitarit 75 të 2 shkurtit 2011 ishte shkelje e Rregullës 68, megjithëse deklaroi se shkelja ishte vetëm në lidhje me pohimin e Dëshmitarit 75 se ai e kishte gënjyer avokatin e tij të azilit për rrethanat e vdekjes së vëllait të tij.⁸⁸ Mirëpo mosnxjerrja e Mesazhit Elektronik gjithashtu ishte shkelje e Rregullës 68 sepse në të Dëshmitari 75 kërkonte shprehimisht ndihmën e Prokurorisë për kërkesën e azilit të tij. Për arsye se Dëshmitari 75 ishte dëshmitar i zbuluar me vonesë, Prokuroria duhej ta kishte bërë të njohur Mesazhin e tij Elektronik më 18 korrik 2011.

⁸⁵ Shih për shembull Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para 178-180.

⁸⁶ Rregulla 68.

⁸⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para 178. Shih po aty 179-180; Vendimi *Llukiq*, para 14; Vendimi *Furunxhija*, para 16-21.

⁸⁸ Përgjigje, para 10.

50. Prokuroria deklaron se mosnxjerrja e këtij mesazhi elektronik në fjalë ishte “e vetmja shkelje për mosnxjerrje materiali”.⁸⁹ Ky pohim është i pasaktë.

51. Së pari Prokuroria duhej të kishte nxjerrë Letrën e z. Rogers për Mbrojtjen brenda datës 18 korrik 2011. Ajo nuk e nxori Letrën deri më 31 gusht 2011, gjatë dhënies së dëshmisë nga Dëshmitari 75. Së dyti Prokuroria duhej t’i kishte bërë të njohur Mbrojtjes deri më 18 korrik 2011, kërkesën e avokatit të azilit në përgjigje të së cilës z. Rogers dërgoi Letrën.⁹⁰ Z. Rogers e nxori materialin vetëm pasi iu kërkua nga Kryegjykatësi më 1 shtator 2011.⁹¹ Së treti, Prokuroria duhej të kishte bërë menjëherë të njohur se organi i apelit i Vendit të Pidentifikuar kishte rihapur çështjen e azilit të Dëshmitarit 75 mbi bazën e Letrës së z. Rogers. Këtë informacion z. Rogers e mori më 30 gusht 2011,⁹² por nuk e bëri të njohur deri më 1 shtator 2011⁹³ pas kërkesës këmbëngulëse të Mbrojtjes⁹⁴ në një kohë që Dëshmitari 75 ishte duke dëshmuar. Mbrojtjes nuk iu tregua ky informacion ndërsa Dëshmitari 75 po dëshmonte më 31 gusht 2011. Së katërti, gjithashtu Prokuroria duhej të kishte nxjerrë deri më 18 korrik 2011, ose në qoftë se e kishte marrë pas kësaj date menjëherë pas marrjes, provat shtesë që i bëri të njohura në Përgjigje. Provat në fjalë janë:

- a) Një mesazh elektronik të 17 nëntorit 2010 nga avokati për azil i Dëshmitarit 75 dërguar z. Rogers, ku shkruhej se Prokuroria mund të ndihmonte në mbështetjen e kërkesës për azil nëpërmjet një letre për Dëshmitarin 75: “Letra juaj do t’u jepet vetëm autoriteteve të Vendit të Pidentifikuar *si mbështetje e kërkesës për azil të [Dëshmitarit 75]*. Ju falënderoj për *ndihmën tuaj* në këtë çështje”.⁹⁵

⁸⁹ Përgjigje, f. 3.

⁹⁰ Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar hetuesit të Prokurorisë, 5 nëntor 2010, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Pjesa 1.

⁹¹ T. 1009-1010.

⁹² Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar z. Rogers, 30 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 22.

⁹³ Mesazh elektronik nga z. Rogers dërguar Avokatit të Mbrojtjes, 1 shtator 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 12.

⁹⁴ Mesazh elektronik nga z. Harvey dërguar z. Rogers, 31 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 11.

⁹⁵ Mesazh elektronik nga avokati për azil i Dëshmitarit 75 dërguar z. Rogers, 17 nëntor 2010, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 5 (theksi i shtuar).

- b) Një mesazh elektronik të 18 nëntorit 2010 nga avokati për azil i Dëshmitarit 75 dërguar z. Rogers, ku shprehej mirënjohje ndaj z. Rogers për Letrën e dërguar: “Në emër të klientit tim [Dëshmitarit 75] ju falënderoj për *ndihmën tuaj*”.⁹⁶
- c) Një mesazh elektronik i 2 shkurtit 2011 i Dëshmitarit 75 drejtuar një hetuesi të Prokurorisë të titulluar “Për çështjen time!!” ku Dëshmitari 75 kërkonte që Prokuroria t’i telefononte “sa më shpejt”, duke theksuar “Kam diçka shumë të rëndësishme për të diskutuar me ju lidhur me çështjen time”. Dëshmitari 75 e dërgoi këtë mesazh vetëm pak orë para se të dërgonte Mesazhin e tij Elektronik ku pohohej se çështja e tij e azilit ishte “në udhëkryq”.⁹⁷ Këto prova tregojnë se Dëshmitari 75 ishte i shqetësuar lidhur me marrjen e azilit. Për këtë aspekt ka gjithashtu rëndësi fakti se hetuesi mori një mesazh të regjistruar telefonik nga Dëshmitari 75 afërsisht në atë kohë, mirëpo ai “nuk arriti” t’i përgjigjej thirrjes telefonike të Dëshmitarit 75, sepse Dëshmitari 75 i kishte telefonuar pak më vonë në një përpjekje të ethshme për të diskutuar çështjen e azilit të tij dhe për të kërkuar ndihmën e Prokurorisë. Dëshmitari 75 “dukej shumë i shqetësuar” lidhur me çështjen.⁹⁸
- d) Një mesazh elektronik i 30 gushtit 2011 nga avokati për azil i Dëshmitarit 75 dërguar z. Rogers, në kohën që Dëshmitari 75 ishte duke dëshmuar. Avokati për azil i kërkonte z. Rogers që të dërgonte në një kohë të përshtatshme një letër të dytë në mbështetje të kërkesës për azil: “Shpresoj që Dëshmitari 75 të ketë qenë i dobishëm për çështjen tuaj [...] Pas përfundimit të procesit gjyqësor, do t’ju isha mirënjohës nëse shkruani një letër lidhur me dëshminë [e Dëshmitarit 75] dhe jepni mendimin tuaj mbi rrezikun që mund të ballafaqohet po ta kthejnë në Kosovë”.⁹⁹ Së fundi z. Rogers u përgjigj se nuk mund të

⁹⁶ Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar z. Rogers, 18 nëntor 2010, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 7 (theksi i shtuar).

⁹⁷ Mesazh elektronik nga Dëshmitari 75 dërguar hetuesit të Prokurorisë, 2 shkurt 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 11.

⁹⁸ Deklaratë e Hetuesit të Prokurorisë, 8 shtator 2011, para 10-13, 15, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 14.

⁹⁹ Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar z. Rogers, 30 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 22.

dërgonte letër të dytë,¹⁰⁰ siç përmendet më poshtë. Avokati për azil u përgjigj se ai “kërkonte një letër nga z. Rogers si konfirmim se [Dëshmitari 75] kishte dëshmuar në TPNJ në çështjen *Haradinaj*”.¹⁰¹ Prokuroria argumenton se letra të tilla u jepen “rëndom” dëshmitarëve të Tribunalit dhe se “dëshira e Dëshmitarit 75 për marrjen e një letre të tillë nuk ndikon në besueshmërinë e tij”.¹⁰² Përkundrazi, Dhoma gjykon se Dëshmitari 75 priste që të merrte një letër tjetër që konfirmonte se kishte dëshmuar për Tribunalin, e cila mund të jetë e dobishme për çështjen e azilit të tij dhe për pasojë mund të ndikojë në besueshmërinë e tij. Avokati për azil nuk do ta ndërmernte këtë hap për marrjen e një letre të tillë në rast se nuk do të ishte e rëndësishme për rezultatin e çështjes së azilit. Për shembull një letër e tillë mund të përdorej në mbështetje të argumentit se Dëshmitari 75 kishte bashkëpunuar me Prokurorinë dhe mund të ketë pasojë prej kësaj në qoftë se do ta kthenin në Kosovë për shkak të dëshmisë së tij në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*. Rrjedhimisht mesazhi elektronik i 30 gushtit 2011 është gjithashtu material i Rregullës 68.

52. Prokuroria nuk është e saktë kur argumenton se nuk mund të nxjerrë informacion që mund ose mund të mos i ketë dhënë autoriteteve të emigrimit të Vendit të Pidentifikuar për arsye të kërkesës së vendit në fjalë që të gjitha komunikimet e tij me Prokurorinë të mbaheshin konfidenciale.¹⁰³ Vendi i Pidentifikuar nuk u mbështet në Rregullën 70 kur iu përgjigj pyetjeve të Prokurorisë. Edhe po të kishte qenë kështu, kjo rregull vlen për informacion “që i është dhënë konfidencialisht *Prokurorit*” nga një shtet,¹⁰⁴ jo informacion të dhënë një shteti nga Prokuroria. Për më tepër Rregulla 70 nuk e liron Prokurorinë nga detyrimet e Rregullës 68.¹⁰⁵ Rrjedhimisht Prokuroria duhet t’i bëjë të njohur Mbrojtjes çfarëdo informacioni për Dëshmitarin 75 që mund ose mund të mos u ketë dhënë autoriteteve të emigrimit të Vendit të Pidentifikuar.

¹⁰⁰ Mesazh elektronik nga z. Rogers dërguar avokatit për azil, 1 shtator 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 25.

¹⁰¹ Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar z. Rogers, 1 shtator 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 26.

¹⁰² Përgjigje, para 21.

¹⁰³ Shih Përgjigje, para 7.

¹⁰⁴ Rregulla 70(B).

¹⁰⁵ *Prokurori k. Bllashkijit*, Lënda Nr. IT-95-14-A, Vendim Konfidencial dhe *Ex Parte* mbi Njoftimin prej Prokurorisë Lidhur me Materialin e Rregullës 70, 18 maj 2004, f 4-5; *Prokurori k. Bërgjaninit*, Lënda Nr. IT-99-36-T, Versioni Publik i Vendimit Konfidencial mbi Pretendimin për Paligjshmërinë e Rregullës 70 i 6 majit 2002, para 19-20.

53. Së fundi nga argumentet e Prokurorisë nuk del qartë nëse autoritetet e emigrimit të Vendit të Pidentifikuar kërkuar mbajtjen e konfidencialitetit të komunikimeve me Prokurorinë në kohën kur i dhanë informacion Prokurorisë dhe në qoftë se kjo ka ndodhur, kur ka ndodhur dhe mbi çfarë baze u kërkuar konfidencialiteti. Në këto rrethana, Dhoma fton Prokurorinë që t'i bëjë të njohur Mbrojtjes materialin në fjalë ose të paraqesë një kërkesë për t'u liruar prej detyrimeve për nxjerrjen e materialit në përputhje me Rregulloren.

3. Konkluzion

54. Përmbledhtazi, Dhoma konkludon se Prokuroria ka kryer disa shkelje të rënda të Rregullës 68 nëpërmjet mosnxjerrjes në kohë të materialeve të rëndësishme për vlerësimin e besueshmërisë së Dëshmitarit 75. Prokuroria kishte detyrë t'i nxirrte Mbrojtjes të gjitha materialet që kishte lidhur me çështjen e azilit të Dëshmitarit 75, sepse Dëshmitari 75 kërkoj dhe faktikisht përfitoi ndihmë duke qenë dëshmitar i Prokurorisë.

55. Materiali në fjalë ishte brenda kuadrit të kërkesës së Mbrojtjes për nxjerrje materiali të 27 janarit 2011, ku ajo kërkoj material lidhur me “premtim” ose “joshje” lidhur me “rivendosjen në një vend tjetër” të dëshmitarit dhe familjes së tij.¹⁰⁶ Mbrojtja bëri disa kërkesa të tjera për material të Rregullës 68. Gjithsesi z. Rogers kishte detyrë t'i nxirrte këto prova brenda 18 korrikut 2011, pavarësisht nëse Mbrojtja kishte kërkuar ose nuk kishte kërkuar shprehimisht nxjerrjen e tyre.

B. Analizimi i Paragjykimit ndaj Mbrojtjes

56. Dhoma gjykon se Mbrojtja është paragjykuar për shkak se nxjerrja e materialeve të lartpërmendura prej Prokurorisë ndodhi në një fazë tepër të vonuar. Mbrojtja nuk u informua për faktin se Dëshmitari 75 kërkoj dhe faktikisht përfitoi ndihmë si dëshmitar i Prokurorisë, pikë e rëndësishme për besueshmërinë e tij. Mbrojtja kishte të drejtë të njëjës me këtë informacion në mënyrë që të përgatitej në mënyrën e duhur për gjyqin dhe për të pyetur Dëshmitarit 75 mbi çështjen. Mirëpo Prokuroria nuk i nxori materialet në kohë në mënyrë që Mbrojtja të ishte e përgatitur.

¹⁰⁶ Kërkesë nga Richard Harvey për Nxjerrje Materiali, 27 janar 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 3.

57. Sidoqoftë Dhoma gjykon se paragjykimi është zhdëmtuar nëpërmjet vendimit të saj për shtyrjen e dëshmidhënies së Dëshmitarit 75 për t'i mundësuar Mbrojtjes përgatitje të pyetjeve për dëshmitarin. Gjithashtu Dhoma gjykon se vonesat e shkaktuara nga shkeljet e Prokurorisë në vetvete nuk shkojnë deri aty sa të kenë shkelur të drejtat e të Akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë. Duke vënë këtë në dukje, Dhoma gjithsesi thekson se interpretimi papërshtatshmërisht i ngushtë i Rregullës 68 nga Prokuroria mund të shkaktojë paragjykim të mëtejshëm ndaj Mbrojtjes në qoftë se kjo bën që Prokuroria të mos nxjerrë material analog të Rregullës 68 lidhur me dëshmitarë të tjerë.

C. A duhet të ketë sanksion për z. Rogers

58. Dhoma ka konkluduar se mosnxjerrja në kohë prej Prokurorisë e materialit mbi implikimin e saj në çështjen e azilit të Dëshmitarit 75 ishte shkelje e Rregullës 68. Mbrojtja argumenton se z. Rogers ka kryer kundërvajtje në lidhje me të cilën ajo kërkon që atij t'i jepet vërejtje. Në shqyrtimin e kësaj kërke, Dhoma thekson se z. Rogers nuk i nxori materialet lidhur me implikimin e Prokurorisë në çështjen e azilit të Dëshmitarit 75 para fillimit të dëshmidhënies prej Dëshmitarit 75; dhe e nxori me hezitim pjesë-pjesë pas kërkesave të shumta këmbëngulëse të Mbrojtjes. Gjithashtu z. Rogers nuk nxori kërkesën e 5 nëntorit 2010 të avokatit për azil¹⁰⁷ deri kur u detyrua për këtë nga Kryegjykatësi në sallën e gjyqit.¹⁰⁸

59. Megjithëse mosnxjerrja prej z. Rogers e Mesazhit Elektronik të 2 shkurtit 2011¹⁰⁹ nga Dëshmitari 75 mund të ketë qenë “pakujdesi”,¹¹⁰ ai vendosi të mos e nxirrte pjesën tjetër të materialit në kohë duke arsyetuar se nuk kishte lidhje me Rregullën 68, pikë ku ai ishte shumë këmbëngulës.¹¹¹ Argumenti i z. Rogers lë të kuptohet se ai bën një interpretim papërshtatshmërisht të ngushtë të detyrimeve të Prokurorisë në bazë të Rregullës. Të gjithë materialet që mund të hedhin hije mbi dëshminë e dëshmitarit duhet të bëhen të njohura sipas Rregullës 68. Veçanërisht, vendimet e Prokurorisë sipas Rregullës 68 nuk janë të lidhura vetëm me synimet për të kërcënuar, ofruar premtime ose joshje një dëshmitari.

¹⁰⁷ Mesazh elektronik nga avokati për azil dërguar hetuesit të Prokurorisë, 5 nëntor 2010, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 1.

¹⁰⁸ T. 1009-1010.

¹⁰⁹ Mesazh elektronik dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Mocionit, Shtesa 1.

¹¹⁰ Përgjigje, para 10.

¹¹¹ T. 884, 951-952, 954, 1001, 1006; Përgjigje, para 11, 21.

60. Logjikisht nuk është e mundur që z. Rogers të ketë menduar se nuk kishte detyrë të bënte të njohur se Dëshmitari 75 kishte kërkuar dhe faktikisht kishte marrë ndihmë për çështjen e azilit si dëshmitar i Prokurorisë. Gjithashtu, edhe pse z. Rogers këmbëngul se ai nuk synonte që me Letrën e tij të ndihmonte Dëshmitarin 75 për marrjen e azilit,¹¹² dokumentet tregojnë se Prokuroria nuk ishte e paaftësuar për rezultatin e çështjes së azilit. Z. Rogers ishte i vetëdijshëm për rrezikun e kthimit të Dëshmitarit 75 në Kosovë¹¹³ dhe saktësoi se Letra ishte shkruar “prej shqetësimit për sigurinë dhe mirëqenien e Dëshmitarit 75”.¹¹⁴ Për më tepër, një hetues i Prokurorisë pranoi se “objektivi” i Prokurorisë ishte ardhja e Dëshmitarit 75 në Hagë për të dëshmuar personalisht sepse avokati për azil kishte informuar se Dëshmitari 75 nuk do të lejohet të udhëtonte pa përfunduar çështja e tij e azilit.¹¹⁵ Me fjalë të tjera Prokuroria dhe Dëshmitari 75 kishin interes të ndërsjellë në evitimin e kthimit të tij në Kosovë, që do të kishte vështirësuar sigurimin e dëshmisë së Dëshmitarit 75 për Prokurorinë.

61. Megjithëse mosnxjerrja e Letrës prej z. Rogers ishte shkelje e Rregullës 68, Dhoma thekson se nuk e gjykon të papërshtatshme që letrën e shkroi vetë z. Rogers. Provat që ka Dhoma nuk vërtetojnë se z. Rogers bëri marrëveshje me Dëshmitarin 75, ku ai do të dëshmonte në shkëmbim të ndihmës së Prokurorisë në çështjen e azilit të tij. Veçanërisht, pasi z. Rogers ua kishte dërguar letrën autoriteteve të Vendit të Përditëzuar, avokati për azil informoi një hetues të Prokurorisë se zgjidhja e çështjes së azilit do të përshpejtohej në qoftë se Prokuroria do të ishte më aktive në mbështetje të Dëshmitarit 75.¹¹⁶ Sipas hetuesit, Prokuroria vendosi të mos vepronte në këtë mënyrë dhe si pasojë nuk e kontaktoi zyrtarin e atij vendi që trajtonte çështjen e azilit të Dëshmitarit 75 si rezultat i kësaj kërkesë.¹¹⁷

62. Më 1 shkurt 2011, pas një kontakti tjetër nga avokati për azil, z. Rogers e informoi drejtpërsëdrejti se Prokuroria “nuk do të prononcohet” lidhur me çështjen e azilit të Dëshmitarit 75. “Nuk është puna jonë” theksoi z. Rogers “dhe nuk do të ofrojmë mbështetje

¹¹² Përgjigje, para 12-14; T. 884.

¹¹³ T. 884.

¹¹⁴ Përgjigje, para 12.

¹¹⁵ Deklaratë e Hetuesit të Prokurorisë, 9 shtator 2011, para 6, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 8. Deklarata e cituar e avokatit duket pjesërisht e gabuar sepse Dëshmitari 75 u lejua të vinte për të dëshmuar në Hagë, pavarësisht se kërkesa e tij për azil ende nuk ka marrë përgjigje.

¹¹⁶ Deklaratë e Hetuesit të Prokurorisë, 9 shtator 2011, para 6, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 8.

¹¹⁷ Po aty.

për vendim konkret lidhur me të”.¹¹⁸ Për më tepër, në kohën që Dëshmitari 75 ishte duke dëshmuar para Dhomës, avokati për azil e informoi z. Rogers se çështja e azilit ishte rihapur për procedim të mëtejshëm. Avokati për azil i kërkoi z. Rogers që t’ia përcillte këtë lajm Dëshmitarit 75. Me të drejtë z. Rogers nuk pranoi ta bënte këtë: “Aktualisht Dëshmitari 75 është duke dëshmuar dhe unë nuk mund të komunikoj me të”.¹¹⁹ Gjithashtu z. Rogers refuzoi kërkesën e avokatit për azil për një letër tjetër që do t’u paraqitej zyrtarëve të Vendit të Pidentifikuar në kuadër të kërkesës për azil të Dëshmitarit 75.

Për të shmangur dyshimet dhe sikundër kam deklaruar më parë, dëshiroj të bëj të qartë se Prokuroria nuk mbështet dhe nuk do të mbështesë kërkesën e cilitdo personi për azil ose status refugjati në cilindo vend. Kjo është puna juaj dhe e autoriteteve të emigrimit. Tashmë kam dhënë një vlerësim të rrezikut në letrën time të 18 nëntorit 2010. Nuk kam ç’të shtoj tjetër.¹²⁰

63. Gjithsesi fakti se z. Rogers nuk bëri marrëveshje me Dëshmitarin 75 apo të argumentonte në dobi të tij te autoritetet e Vendit të Pidentifikuar nuk i shfajëson shkeljet e tij të përsëritura të Rregullës 68. Z. Rogers duhej të kishte pranuar pa hezitim rëndësinë e kësaj prove dhe të kishte pranuar kryerjen e disa shkeljeve të Rregullës 68. Kurse z. Rogers ka këmbëngulur në mënyrë të përsëritur dhe jobindëse se kjo provë nuk ka lidhje me dëshminë e Dëshmitarit 75 dhe për analogji me dëshminë e cilitdo dëshmitar tjetër.

64. Rregulla 68bis kushtëzon se shkeljet e Rregullës 68 janë të ndëshkueshme. Dhoma gjykon se dhënia e vërejtjes është e përligjur duke marrë parasysh mosrespektimin e Rregullës 68 nga ana e z. Rogers dhe mosgatishmërinë e tij për të pranuar shkeljen e kësaj rregulle.

D. Masa për Garantimin e Respektimit të Rregullës 68

65. Paraprakisht Dhoma rithekson se Prokuroria ka detyrim të përhershëm për nxjerrjen e materialeve të Rregullës 68, pavarësisht nëse Mbrojtja i ka kërkuar apo nuk ka i ka kërkuar këto materiale.

¹¹⁸ Mesazh elektronik nga z. Rogers dërguar avokatit për azil, 1 shkurt 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 10.

¹¹⁹ Mesazh elektronik nga z. Rogers dërguar avokatit për azil, 30 gusht 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 23.

¹²⁰ Mesazh elektronik nga z. Rogers dërguar avokatit për azil të Dëshmitarit 75, 1 shtator 2011, dorëzuar brenda Shtojcës Konfidenciale A të Përgjigjes, Tab 25.

66. Dhoma ka vendosur të urdhërojë që Prokuroria të dorëzojë një raport ku të konfirmojë se ka kryer verifikim të gjerë të materialit të Rregullës 68 që zotëron lidhur me të gjithë dëshmitarët e saj në këtë proces gjyqësor, të saktësojë çfarë verifikimesh ka kryer, ku janë kryer dhe rezultatet e verifikimeve.¹²¹ Prokuroria duhet ta dorëzojë këtë raport shtatë ditë pas lëshimit të këtij vendimi. Detyrimi për lëshimin e raportit nuk e liron Prokurorinë prej detyrimit të saj të përhershëm për nxjerrjen e menjëhershme të materialit të Rregullës 68 që disponon për Mbrojtjen.

67. Gjithashtu Dhoma e udhëzon Prokurorinë për marrjen e masave për të garantuar që të gjithë punonjësit që punojnë në këtë çështje të vihen plotësisht në dijeni për vendimin e Dhomës dhe t'u përmenden detyrimet e Rregullës 68.

68. Për arsye se në këtë fazë Dhoma i konsideron këto masa të mjaftueshme, Dhoma nuk pranon të miratojë kërkesën e Mbrojtjes për një procedurë të re ku Prokuroria të paraqesë “raport për nxjerrje materiali” së paku shtatë ditë para dhënies së dëshmisë nga secili dëshmitar tjetër.¹²²

E. Kërkesa e Mbrojtjes që Seancat të Jenë Publike

69. Parimisht palët pranojnë që transkriptet e seancave gjyqësore të 31 gushtit dhe 1 shtatorit 2011 mund të bëhen publike me përjashtim të informacionit konfidencial. Dhoma i udhëzon palët të arrijnë një marrëveshje mbi redaktimet e nevojshme dhe t'i raportojnë për këtë problem Dhomës nëpërmjet një parashtrimi formal brenda 14 ditësh pas lëshimit të këtij vendimi.

F. Kërkesa e Mbrojtjes për Materiale nga Vendi i Pidentifikuar

70. Për arsye se Mbrojtja ka kontaktuar drejtpërsëdrejti Vending e Pidentifikuar nëpërmjet një kërkesë për materiale lidhur me Dëshmitarin 75,¹²³ në këtë fazë Dhoma nuk do të marrë asnjë masë. Dhoma e fton Mbrojtjen t'ia ngrejë çështjen Dhomës në qoftë se dhe kur ta gjykojë të nevojshme.

¹²¹ Shih Vendimi *Oriq*, f. 5.

¹²² Mocion, para 37-38.

¹²³ Kundërpërgjigje.

IV. VENDIM

71. Për arsyet e lartpërmendura, me anë të këtij vendimi, Dhoma
- a. **MIRATON** kërkesat përkatëse të palëve për tejkalimin e numrit-kufi të fjalëve në parashtrimet e tyre me shkrim;
 - b. **MIRATON** kërkesën e Mbrojtjes për të paraqitur Kundërpërgjigje dhe merr shënim përmbajtjen e Kundërpërgjigjes;
 - c. **MIRATON** pjesërisht Mocionin;
 - d. **KONKLUDON** se Prokuroria ka shkelur Rregullën 68;
 - e. **I JEP VËREJTJE** z. Rogers në bazë të Rregullës 68*bis*;
 - f. **URDHËRON** që në përputhje me këtë vendim, Prokuroria të nxjerrë të gjitha materialet e Rregullës 68 që disponon lidhur me Dëshmitarin 75 dhe të gjithë dëshmitarët e tjerë të Prokurorisë brenda shtatë ditësh pas dorëzimit të këtij Vendimi dhe njëherazi të dorëzojë një raport ku të saktësojë çfarë verifikimesh janë, kryer, ku janë kryer dhe rezultatet e këtyre verifikimeve;
 - g. **UDHËZON** Prokurorinë që të marrë masa për të garantuar që të gjithë punonjësit që punojnë në këtë çështje të vihen plotësisht në dijeni për vendimin e Dhomës dhe t'u përmenden detyrimet e Rregullës 68;
 - h. **RRËZON** Mocionin lidhur me pikat e tjera;
 - i. **UDHËZON** palët që të arrijnë një marrëveshje mbi redaktimet e nevojshme dhe t'i raportojnë për këtë problem Dhomës nëpërmjet një parashtrimi formal brenda 14 ditësh pas lëshimit të këtij vendimi;

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më 12 tetor 2011.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]